



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

K.DH.SH.II.nr.97/22

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS- Dhoma e Shkallës së Dytë, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Saranda Bogaj Sheremeti, kryetare e kolegjit, Faton Bajrami dhe Dren Rogova, anëtar të kolegjit, në konfliktin administrativ, sipas padisë së paditësit, “Migros Group” Sh.P.K, me seli në Fushë Kosovë, kundër të paditurës Administrata Tatimore e Kosovës (ATK), në Prishtinë, me bazë juridike ndëshkim tatimor, duke vendosur lidhur me ankesën e paditësit, të ushtruar kundër Aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë, Departamenti për Çështje Administrative Divizioni Fiskal, A.nr.139/17, të datës 15.10.2019, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë 25.05.2023, merr;

A K T G J Y K I M

Refuzohet si e pa bazuar ankesa e paditësit, “Migros Group” Sh.P.K, me seli në Fushë Kosovë, e datës 13.01.2020, ndërsa Aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti për Çështje Administrative, Divizioni Fiskal, A.nr.139/17, të datës 15.10.2019, **Vërtetohet**.

A r s y e t i m

Me Aktgjykimin e ankimuar është refuzuar si e pabazuar kërkesëpadia e paditësit, “Migros Group” Sh.P.K me seli në Fushë Kosovë, ndërsa ka mbet në fuqi Vendimi nr.398/2016, i datës 01.12.2016, i Administratës Tatimore të Kosovës në Prishtinë. Shpenzimet e procedurës i bart secila palë.

Kundër këtij aktgjykimi në afatin ligjor ankesë ka ushtruar paditësi, me të cilën e konteston ligjshmërinë e të njëjtit, për shkak të; shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës ligjore, konstatim të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe zbatim të gabuar të drejtës materiale.

Me propozim që aktgjykimi i goditur të priset dhe çështja ti kthehet gjykatës të shkallës së parë në rishqyrtim dhe rivendosje, apo aktgjykimi i ankimuar të ndryshohet ashtu që kërkesëpadia e paditësit të aprovohet si e bazuar me ligj ndërsa vendimi i kundërshtuar i të paditurës të anulohet në tërësi.

Kolegji i kësaj gjykate, vlerësoi ligjshmërinë e aktgjyqimit të kontestuar si në vështrim të nenit 49 të LKA, nenit 81.h të Ligjit për Ndryshimet dhe Plotësimet e Ligjit për Administratën Tatimore dhe Procedurën nr.03/L-222, dhe nenit 194 i LPK-së (ligj i zbatueshëm sipas nenit 63 të LKA), në drejtim të theksimeve në ankesë, dhe pas shqyrtimit edhe të shkresave tjera të lëndës gjen se;

Ankesa është e **pabazuar**.

Nga shkresat e lëndës rezulton se me vendimin e ATK-Departamenti për Ankesa nr.398/2016, i datës 01.12.2016, është refuzuar si e pa bazë ankesa Nr.398/2016 e subjektit “Migros Group” Sh.P.K, me NRF: 6000875085 me drejtor z.M.R., me seli të biznesit në Shtime, në mbështetje të nenit 136/a të Ligjit nr.02/L-28 për Procedurën Administrative, në lidhje me paragrafin 2 të nenit 89 të Ligjit Nr. 03/L-222, për Administratën Tatimore dhe Procedurat, dhe Dokumenti i Vendosjes së Ndëshkimit të datës 01.09.2016 me nr. MFA2R00000087227Q, në vlerë prej 18,621.00 euro, dhe atij me nr. MFA2R00000087228S në vlerë prej 1,000.00 të lëshuar nga Administrata Tatimore, vërtetohet si të bazuar.

I pakënaqur me vendimin e ATK-së, paditësi ushtron padi në gjykatën e shkallës së parë, në procedurë të konfliktit administrativ dhe gjykata e shkallës së parë pas administrimit të provave si në procesverbalin e seancës së shqyrtimit kryesor, të mbajtur me datë 15.10.2019, në prani të përfaqësuesit të autorizuar të paditësit, e në mungesë të palës së paditur dhe pas administrimit të provave gjatë vlerësimit të ligjshmërisë së aktvendimit të organit të paditur dhe vërtetimit të gjendjes faktike, merr aktgjykimin e ankimuar, me të cilin e refuzon kërkesëpadinë e paditësit si të pa bazuar dhe len në fuqi vendimin e të paditurës, sipas konkludimeve si në arsyetim ndër të tjera se: nga provat e administruara në këtë konflikt administrativ, gjykata nga dokumenti i titulluar forme për vizitat përmbushëse i datës 05.09.2016 i ATK-së, dokumentet e vendosjes së ndëshkimeve të datës 01.09.2016, si dhe vendimi kontestues ka nxjerr konstatimin se inspektorët tatimor të paditurës me datat 06.06.2016, 07.06.2016 dhe me datë 08.06.2016, me qëllim të verifikimit të mbajtjes së librave

dhe regjistrimeve dhe verifikimin e stokut, kanë realizuar vizita tatimore tek tatimpaguesi “Migros Group” Sh.P.K këtu paditësi. Nga këto vizita është konstatuar se tatimpaguesi posedon mall pa mbulesë apo pa origjinë në vlerë prej 74,485.43€, i cili mall nuk është i përfshirë në listën e stokut, me vlerë financiare në bazë të çmimit shitës të ofruar nga tatimpaguesi. Si rezultat i pa rregullsive të evidentuara, paditësi me pastaj me Dokumentin e Vendosjes së Ndëshkimit me nr.MFA2R0000087227Q nga ana e inspektorit tatimor është ndëshkuar me ndëshkim administrativ në shumë prej 18,621.00€ apo 25% e vlerës së mallit të kontestuar pa origjinë në vlerë prej 74,485.43€, në mbështetje të nenit 59 të Ligjit nr. 03/L-222 për Administratën Tatimore dhe Procedurat. Krahas këtij ndëshkimi e paditura, bazuar në nenin 53.2.4 të Ligjit nr.03/L-222, paditësin e ka ndëshkuar edhe me një gjobë mandatorë në shumë prej 1,000.00€ për mos krijim dhe mos mbajtje të regjistrimeve.

Po ashtu gjykata nga shkresat e lëndës rezulton se deri tek sasia e mallit e konstatuar si mall pa mbulesë me dokumentacion përkatës në vlerë prej 74,485.43€, ka ardhur nga numërimi i realizuar nga ana e zyrtarëve të ATK-së dhe personave përgjegjës të paditësit, gjithnjë duke u bazuar në krahasimin me regjistrimin e stokut të paraqitur nga paditësi të njohur si “llager lista” me gjendjen faktike të konstatuar gjatë numërimit të mallit. Po ashtu procesverbali mbi numrin e stoqeve është nënshkruar nga palët pjesëmarrës përfshirë edhe personat përgjegjës të paditësit, çka nënkupton që gjendja faktike e konstatuar gjatë numërimit të mallit është pranuar edhe nga paditësi. Në rast se paditësi ka pasur vërejtje se nuk është numëruar i gjithë malli prezent apo ka pasur lëshime gjatë numërimit, kjo gjykatë vlerëson se personat përgjegjës të paditësit është dashur të bëjnë vërejtje konkrete me shkrim në proceset e numërimit e gjë të cilën nga shkresat e lëndës rezulton që paditësi nuk e ka bërë, duke përjashtuar vërejtjen se stoku është dinamik, mirëpo për gjykatën kjo nuk paraqet vërejtje të bazuar se nuk është numëruar i gjithë malli i cili ka pasur për tu numëruar apo që numërimi nuk është bërë në mënyrën e duhur siç pretendon paditësi.

Qëndrimin juridik të gjykatës së shkallës së parë si të rregullt dhe të bazuar në prova dhe ligj, në tërësi e aprovon edhe kjo gjykatë. Aktgjykimi ankimur nuk është i përfshirë me shkelje qenësore të dispozitave të LKA dhe të LPK, siç pretendohet në ankesë dhe as me shkelje të tjera të cilat kolegji i vlerëson sipas detyrës zyrtare si në vështrim të nenit 194 të LPK-së.

Kolegji i Gjykatës Komerciale-Dhoma e shkallës së dytë, vlerëson se gjykata e shkallës së parë ka vlerësuar drejtë ligjshmërinë e aktit përfundimtar-vendimit të atakuar nga paditësi, si në

vështrim të nenit 9 dhe 44 të LKA, në të cilin aktvendim në procedurë administrative e gjithashtu sipas aktgjykimit të ankimuar me ankesë, edhe në procedurë gjyqësore në mënyrë të plotë është vërtetuar gjendja faktike, ngase nga vizita e inspektorit tatimor tek paditësi, Kolegji vëren se paditësi, nuk i ka mbajtur regjistrat me rregull, ka pasur parregullsi në mungesë të stoqeve dhe mall pa origjinë, e që me këtë veprim, paditësi, ka rënë ndesh me nenin 53.2.4, ku sipas kësaj dispozite parashihet që “2. Çdo person i nga i cili kërkohet të krijojë ose mbajë regjistrime, përfshirë kërkesën për të vendosur numrin fiskal të biznesit në të gjithë kuponët dhe faturat e lëshuara, sipas legjislacionit të zbatueshëm në Republikën e Kosovës dhe i cili nuk e kryen këtë do t’i nënshtrohet një ndëshkimi administrativ si vijon: 2.1. tatimpaguesi me qarkullim vjetor deri tridhjetëmijë (30,000) Euro, ndëshkim administrativ prej njëqindnjëzetepesë (125) Euro, 2.2. tatimpaguesi me qarkullim vjetor nga tridhjetëmijë (30,000) deri dyqind mijë (200,000) Euro –ndëshkim administrativ prej dyqindepesëdhjetë (250) Euro; 2.3. tatimpaguesi me qarkullim vjetor nga dyqind mijë (200,000) deri pesëqind mijë (500,000) Euro – ndëshkim administrativ prej pesëqind (500) euro; ose 2.4. tatimpaguesi me qarkullim vjetor prej pesëqind mijë (500,000) dhe më shumë – ndëshkim administrativ prej njëmijë (1,000) Euro. 4. Rregullat procedurale për vendosjen e kohës brenda së cilës transaksionet duhet të futen në librat e kontabilitetit për qëllime të ndëshkimit të paraparë në paragrafin 2 të këtij neni do të rregullohet me akt nënligjor.” Po ashtu me nenin 59 përcaktohet se: “Kur një person i angazhuar në aktivitet ekonomik posedon mallra pa origjinë ai person do t’i nënshtrohet ndëshkimit administrative me njëzetepesë për qind (25%) të vlerës së tregut të mallrave. Ato mallra mund të merren dhe të mbahen në kujdestari të ATK-së me qëllim të caktimit të detyrimit penal. Në këtë rast, do të ndiqen procedurat për vlerësim për rrezik në nenin 21 të këtij ligji, dhe procedurat e marrjes së mallit dhe shitja e tyre do të rregullohet me dispozitat e neneve 34, 35 dhe 36 të këtij ligji. Drejtori i Përgjithshëm mund të lëshojë një urdhër për rrezik sikurse është paraparë në nenin 39 të këtij ligji”. Andaj, paditësi në bazë të dispozitave të lartcekura ka qenë i obliguar të mbaj regjistrat me rregull, sipas kërkesave ligjore.

Pretendimet ankimore të paditësit të cekura si më lartë, dhe të shtjelluara si në arsyetim të ankesës për shkeljet e pretenduara nga gjykata e shkallës së parë, kolegji i vlerëson se janë të pa bazuara dhe të pa qëndrueshme për vendosjen e kësaj çështje në mënyrë tjetër, sepse nuk dëshmohet se aktgjykimi i goditur është i nxjerrë me shkelje të dispozitave të LKA dhe LPK. Kolegji gjen se gjykata e shkallës së parë e ka proceduar çështjen në baza ligjore e gjithashtu, gjendja faktike e çështjes është vërtetuar në mënyrë të plotë dhe janë nxjerrë prova të

mjaftueshme në bazë të cilave është vërtetuar se kërkesë padia është e pa bazuar, sepse janë në kundërshtim me gjendjen e vërtetuar nga organi i paditur si në Vendimin e saj, i nxjerrë në pajtim me dispozitat ligjore. Sepse nga vizita e inspektorit tatimor e datës 06.06.2016, 07.06.2016 dhe me datë 08.06.2016 vërtetohet se paditësi-tatimpaguesi ka pasur parregullsi në mbajtjen e regjistrimeve të tij, dhe për këtë arsye është ndëshkuar me gjobë administrative, duke u bazuar në nenin 53 par.2.4 dhe neni 59 të Ligjit nr.03/L-222.

Mbi këtë gjendje të fakteve Kolegji i kësaj Gjykate, vlerëson se gjykata e shkallës së parë dhe organi administrativ përfundimtar ATK, drejtë kanë zbatuar dispozitat e ligjore procedurale dhe materiale për ATK-në, dhe nuk është cenuar ligji në dëm të paditësit, e gjithashtu gjendja faktike e çështjes është vërtetuar në mënyrë të plotë, andaj thëniet në ankesë nuk aprovohen dhe nuk janë me ndikim për vendosjen ndryshe të çështjes, kështu që aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë vërtetohet si drejtë, dhe i bazuar në prova dhe ligj.

Nga të lartcekurat e në vështrim të nenit 49 të LKA dhe nenit 200 të LPK, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhomat e Shkallës së Dytë

K.DH.SH.II.nr.97/22, me datë 25.05.2023

**Kryetare e kolegjit,
Saranda Bogaj Sheremeti**